

**MARRËVESHJE PËR PJESËMARRJE NË PROGRAMIN “SFIDON” TË WORLD VISION ALBANIA
 (“Marrëveshje”)**

Ky dokument lidhet sot më datë _____, 2026, mes Palëve si më poshtë:

Fondacioni “WORLD VISION ALBANIA”, një organizatë jofitimprurëse, e regjistruar në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse sipas Vendimit nr. 2544, datë 09.09.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, NIPT J92127018B,

(këtu e më poshtë referuar si “**WVA**”)

dhe

_____ Shtetas _____, lindur në _____, më datën _____, mbajtës i numrit personal _____, banues në _____ Mob: +355 _____.

(këtu e më poshtë referuar si “**Prindi/Kujdestari Ligjor**”)

Për pjesëmarrjen në kampin veror SfidON të Fëmijës:

_____ Shtetas _____, lindur në _____, më datën _____, banues në _____.

(këtu e më poshtë referuar si “**Fëmija**”)

DEKLARIME PARAPRAKE:

- A. World Vision Albania (WVA) është një organizatë jofitimprurëse e themeluar në formën e fondacionit, e cila ka si objekt të veprimtarisë së saj fuqizimin e fëmijëve, familjeve dhe komuniteteve në nevojë. Në përmbushje të qëllimit të saj, në përputhje me ligjin dhe statutin, WVA ka vendosur të organizojë një Program në formën e kampeve ditore për fëmijë dhe adoleshentë në zonën e Arbanës, me adresë Qendrën “Anton Luli”, në Arbanë.
- B. Për qëllim të pjesëmarrjes në këtë Program, WVA në cilësinë e organizatorit, dhe prindi/kujdestari ligjor i fëmijës bien dakord të lidhin këtë Marrëveshje, në përputhje me kushtet e përcaktuara në vijim.

PËR RRJEDHOJË dhe në konsideratë të sa më sipër, Palët bien dakord si vijon:

Neni 1 – Objekti

1.1. Kjo Marrëveshje ka për qëllim të përcaktojë në mënyrë të qartë dhe të plotë kushtet, të drejtat dhe përgjegjësitë reciproke të palëve lidhur me pjesëmarrjen e Fëmijës në Programin e organizuar dhe administruar nga WVA, i zhvilluar në formën e kampeve ditore, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, aktivitetet edukative, rekreative, sociale dhe sportive që realizohen gjatë kohëzgjatjes së tij (“**Programi**”). Pjesëmarrja e Fëmijës në Program bëhet në përputhje me këtë Marrëveshje, rregullat e brendshme dhe udhëzimet e WVA.

1.2. Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje, Prindi (ose kujdestari ligjor) deklaron dhe garanton se ka lexuar me kujdes, ka kuptuar plotësisht dhe pranon pa rezerva të gjitha dispozitat e saj, si dhe çdo rregull, politikë, procedurë apo udhëzim të nxjerrë nga WVA në lidhje me organizimin dhe zhvillimin e Programit, të cilat konsiderohen pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj Marrëveshjeje. Prindi konfirmon gjithashtu pëlqimin për pjesëmarrjen e Fëmijës në Program, në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë Marrëveshje.

Neni 2 – Përshkrimi i Programit

2.1. Programi zhvillohet si kamp ditor, në ambientet e Qendrës “Anton Luli”, Arbanë, Tiranë, në përputhje me periudhën e përcaktuar në formularin e regjistrimit. Kampi zhvillohet nga e hëna në të premte duke filluar me dorëzimin e Fëmijës në orën **08:00** dhe duke përfunduar me dorëzimin nga ana e WVA të Fëmijës brenda orës 17:00.

2.2. Dorëzimi i Fëmijëve bëhet nga Prindërit në orën **08:00**, ndërsa marrja e tyre deri në orën **17:00** në pikat e takimit të dakordësuara me WVA.

2.3. Programi përfshin një kombinim të balancuar aktivitetesh edukative, rekreative, sociale dhe sportive, të hartuara në përputhje me moshën dhe nevojat e Fëmijëve, me synim ndërtimin e karakterit dhe vlerave, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

- aktivitete mesimore dhe zhvillimore (punë kreative, lexim, lojëra edukative);
- aktivitete sportive dhe fizike;
- aktivitete sociale dhe bashkëpunuese;
- aktivitete në natyrë dhe eksploruese;
- masterclass me profesionistë të fushave të ndryshme.

2.4. Të gjitha aktivitetet zhvillohen në ambiente të sigurta, të kontrolluara dhe të përshtatura për Fëmijët, nën mbikëqyrjen e vazhdueshme të stafit të kualifikuar dhe të autorizuar nga WVA, duke respektuar standardet e sigurisë dhe mirëqenies së Fëmijëve.

2.5. Programi i SfidON siguron një strukturë ditore të organizuar, duke përfshirë ndarjen e Fëmijëve në grupe sipas moshës, rotacionin e temave të programit dhe mbikëqyrje të vazhdueshme gjatë gjithë kohëzgjatjes së qëndrimit në SfidON.

2.6. WVA rezervon të drejtën të modifikojë, shtyjë ose anulojë pjesë të aktiviteteve, orarin ditor apo aktivitetet specifike për arsye operationale, logjistike, sigurie, kushte atmosferike apo në raste të forcës madhore. Çdo ndryshim do t'u komunikohet Prindërve në kohë të arsyeshme.

Neni 3 – Pagesa dhe Kushtet e Regjistrimit

3.1. Tarifa e pjesëmarrjes ne Program është në shumën _____ LEK, e cila duhet të paguhet e plotë përpara fillimit të Programit SfidON.

3.2. Pagesa kryhet nëpërmjet transfertës bankare në llogarinë e përcaktuar nga WVA si më poshtë:

- Emri i përfituesit: _____
- IBAN: _____
- Banka: _____
- Përshkrimi i pagesës: Emri mbiemri i Fëmijës + Kampi Veror SfidON

3.3. Momenti i kryerjes së pagesës së plotë në llogarinë bankare të WVA konsiderohet si momenti i regjistrimit të Fëmijës. Në rast se regjistrimi anulohet nga prindi deri në shtatë ditë para fillimit të kampit, pagesa e kryer kthehet duke mbajtur një komision administrimi në vlerën 5 000 LEK. Pas këtij afati, pagesa është e pakthyeshme dhe nuk rimbursohet, përveç rasteve kur WVA vendos anulimin e programit nga ana e saj.

Neni 4- Të drejtat dhe Detyrimet e WVA

4.1. Të drejtat e WVA:

- të pezullojë përkohësisht ose të ndërpresë përfundimisht pjesëmarrjen e Fëmijës në rast të shkeljes së rregullave, sjelljes së papërshtatshme apo krijimit të rrezikut për veten ose për fëmijët e tjerë;
- të ndërmarrë masa proporcionale dhe në përputhje me rrethanat, për garantimin e mbarëvajtjes së Programit;

- të përcaktojë dhe përditësojë rregullat e brendshme të Programit dhe mënyrën e organizimit të aktiviteteve, në përputhje me nevojat operacionale.

4.2. Detyrimet e WVA:

- të organizojë, administrojë dhe zhvillojë Programin në përputhje me këtë Marrëveshje dhe Standardet e Kampit, duke garantuar një mjedis të strukturuar dhe të përshtatshëm për zhvillimin e aktiviteteve;
- të sigurojë mbikëqyrje të vazhdueshme nga staf i trajnuar dhe i kualifikuar, në raport të arsyeshëm me numrin dhe moshën e Fëmijëve;
- të garantojë që ambientet dhe pajisjet e përdorura gjatë aktiviteteve të jenë të sigurta, të kontrolluara dhe të përshtatshme për moshën e pjesëmarrësve;
- të informojë Prindërit, brenda një kohë të arsyeshme, për çdo çështje të rëndësishme që lidhet me mirëqenien, sjelljen apo pjesëmarrjen e Fëmijës në program;
- të marrë masa të arsyeshme dhe proporcionale për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së Fëmijëve gjatë zhvillimit të aktiviteteve, përfshirë ndërhyrjen në rast incidentesh apo situatash emergjente.

Neni 5- Të drejtat dhe Detyrimet e Prindit/Kujdestarit Ligjor

5.1. Të drejtat e Prindit:

- të informohet në mënyrë të vazhdueshme mbi zhvillimin e programit dhe pjesëmarrjen e Fëmijës në aktivitetet e kampit;
- të komunikojë me WVA për çdo shqetësim, kërkesë apo informacion që lidhet me mirëqenien e Fëmijës;
- të kërkojë informacion mbi kushtet e sigurisë, organizimin dhe menaxhimin e aktiviteteve;
- të marrë njoftime për çdo ndryshim të rëndësishëm në program apo rrethana që ndikojnë në pjesëmarrjen e Fëmijës.

5.2. Detyrimet e Prindit

- të japë informacion të saktë, të plotë dhe të përditësuar mbi gjendjen shëndetësore të Fëmijës, përfshirë alergjitë, trajtimet mjekësore, nevojat e veçanta apo çdo rrethanë që mund të ndikojë në pjesëmarrjen e tij/saj;
- të respektojë dhe të zbatojë oraret e dorëzimit dhe marrjes së Fëmijës;
- të sigurojë që Fëmija të respektojë rregullat e brendshme të kampit, udhëzimet e stafit dhe standardet e sjelljes së përshtatshme;
- të bashkëpunojë në mirëbesim me stafin e programit për çdo çështje që lidhet me Fëmijën dhe të njoftojë në kohë për mungesat apo çdo ndryshim që mund të ndikojë në pjesëmarrje;
- të mbajë përgjegjësi për çdo dëm material apo jo-material të shkaktuar nga Fëmija si pasojë e sjelljes së qëllimshme ose neglizhente.

Neni 6- Mbrojtja e Fëmijëve dhe Përputhshmëria me Politikat

6.1. Politika e WVA për Mbrojtjen e Fëmijëve bashkëlidhet me këtë Marrëveshje si **Shtojca D**, si dëshmi e standardeve dhe praktikave që zbatohen nga WVA në kuadër të mbrojtjes së fëmijëve. WVA mban përgjegjësi për zbatimin e kësaj Politike në përputhje me detyrimet ligjore dhe standardet përkatëse.

6.2. Zbatimi i këtyre politikave përbën një detyrim ligjor dhe etik për WVA dhe ka për qëllim garantimin e mbrojtjes, sigurisë dhe mirëqenies së Fëmijëve gjatë gjithë kohëzgjatjes së pjesëmarrjes në Programin e WVA. Çdo veprim në lidhje me Fëmijët kryhet në përputhje me këtë Marrëveshje, me politikat përkatëse dhe me legjislacionin në fuqi, duke vendosur në çdo rast në plan të parë interesin më të lartë të fëmijës.

6.3. WVA angazhohet të sigurojë që të gjithë punonjësit, vullnetarët, bashkëpunëtorët dhe çdo person tjetër i përfshirë në organizimin dhe zhvillimin e Programit, të jenë të informuar, të trajnuar dhe të detyruar të zbatojnë Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve. WVA rezervon të drejtën të verifikojë përshtatshmërinë e këtyre personave dhe të marrë çdo

masë të nevojshme për parandalimin e çdo forme abuzimi, neglizhence, shfrytëzimi, diskriminimi apo sjelljeje të papërshtatshme.

6.4. Prindi angazhohet të bashkëpunojë me stafin e SfidON në zbatimin e masave që lidhen me mbrojtjen dhe sigurinë e Fëmijëve, si dhe të njoftojë menjëherë stafin për çdo rrethanë apo situatë që mund të përbëjë rrezik aktual apo potencial për Fëmijën e tij/saj apo për fëmijë të tjerë pjesëmarrës.

6.5. Palët njohin dhe pranojnë se çdo çështje që lidhet me Fëmijët trajtohet me përparësi të veçantë dhe mbrojtje të posaçme. Çdo ndërveprim me Fëmijët kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e mbrojtjes së të miturve, duke respektuar dinjitetin, privatësinë dhe integritetin e tyre.

6.6. Në rast se stafi i SfidON vihet në dijeni për një rast të mundshëm abuzimi, neglizhence apo rreziku ndaj një Fëmije, ai angazhohet të ndërmarrë menjëherë masat e nevojshme për garantimin e sigurisë së Fëmijëve, në përputhje me procedurat e saj të brendshme dhe legjislacionin në fuqi.

6.7. Programi SfidON zbaton rregullore dhe procedura të brendshme që përcaktojnë standardet e mbrojtjes së Fëmijëve, si dhe mënyrat konkrete të raportimit dhe trajtimit të çdo shqetësimi apo sinjalizimi që lidhet me sigurinë dhe mirëqenien e tyre.

Neni 7 – Rregullat e Sjelljes së Fëmijëve

7.1. Fëmija angazhohet të respektojë në mënyrë të plotë dhe të vazhdueshme rregullat e sjelljes të përcaktuara nga WVA, si dhe çdo udhëzim të dhënë nga stafi gjatë zhvillimit të aktiviteteve. Në veçanti, ndalohej çdo formë dhune fizike, verbale apo digjitale, bullizimi në të gjitha format, diskriminimi, sjelljeje kërcënuese apo të rrezikshme për veten ose të tjerët, si dhe çdo akt mosbindjeje ndaj udhëzimeve të stafit apo rregullave të kampit. Fëmija duhet të kontribuojë në ruajtjen e një mjedisi të sigurt, respektues dhe bashkëpunues për të gjithë pjesëmarrësit.

7.2. Në rast të shkeljes së këtyre rregullave, WVA angazhohet të njoftojë dhe të komunikojë me Prindin (ose kujdestarin ligjor) në lidhje me problematiken e konstatuar, me qëllim adresimin dhe zgjidhjen e saj në mënyrë të përbashkët. Nëse, pavarësisht komunikimit dhe masave të marra, situata nuk zgjidhet ose përsëritet, WVA mund të pezullojë fëmijën dhe/ose ta përjashtojë përfundimisht fëmijën nga Programi.

7.3. Në rast pezullimi ose përjashtimi për shkak të shkeljeve të rregullave apo sjelljes së papërshtatshme, WVA nuk ka asnjë detyrim për rimbursimin e pagesës së kryer.

Neni 8 – Pranimi i Rrezikut dhe Përgjegjësia

8.1. Prindi pranon dhe kupton se natyra e Programit përfshin pjesëmarrjen në aktivitete edukative, rekreative dhe fizike, të cilat mund të shoqërohen me rreziqe të arsyeshme dhe të zakonshme, përfshirë, por pa u kufizuar në, aktivitete sportive, lojëra në ekip, lëvizje dhe qëndrime në ambiente të hapura apo në natyrë, si dhe ndërveprim me pjesëmarrës të tjerë. Prindi deklaron se është i ndërgjegjshëm për këto rreziqe dhe, me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje, i pranon dhe i merr përsipër ato.

8.2. Prindi deklaron gjendjen shëndetësore të Fëmijës në mënyrë që WVA të marrë parasysh përshtatjen e aktiviteteve. Pjesëmarrja e Fëmijës bëhet me vullnet të lirë dhe me përgjegjësi të plotë të Prindit për rreziqet e zakonshme që lidhen me to.

8.3. Në masën e lejuar nga legjislacioni në fuqi, Prindi heq dorë nga çdo pretendim, ndaj WVA, stafit të saj, bashkëpunëtorëve apo përfaqësuesve, për dëme materiale apo jo-materiale që mund të lindin si pasojë e rreziqeve të zakonshme dhe të pritshme të aktiviteteve të Programit.

Neni 9 – Miratimet

9.1. WVA në zbatim të ligjit 124/2024 “Për Mbrojtjen e të Dhënave” përpunon të dhënat personale të Fëmijës vetëm për qëllime që lidhen me organizimin, administrimin dhe zhvillimin e Programit, si dhe për garantimin e sigurisë dhe mirëqenies së Fëmijës. Miratimi për përpunimin e të dhënave personale jepet dhe formalizohet në **Shtojcën A**.

9.3. Miratimi për realizimin dhe përdorimin e fotografive dhe/ose videove të Fëmijës gjatë Programit, jepet në mënyrë të veçantë dhe vullnetare nga Prindi dhe formalizohet në **Shtojcën B**.

9.4. Miratimi për pjesëmarrjen e Fëmijës në aktivitete jashtë lokacionit të zakonshem të Programit jepet paraprakisht dhe në mënyrë vullnetare nga Prindi dhe formalizohet në **Shtojcën C**.

Neni 10- Njoftimet

10.1. Njoftimet apo çdo lloj tjetër komunikimi mes palëve, në lidhje me këtë Marrëveshje, do të bëhet me anë të mjeteve të komunikimit si më poshtë:

Për WVA: Z. _____

Tel: _____

Email: _____

Prindi/Kujdestari Ligjor: Z. _____

Tel: _____

Email: _____

Neni 11- Përfundimi i Marrëveshjes

11.1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga Palët dhe mbetet në fuqi deri në përfundimin e Programit. Marrëveshja përfundon automatikisht me përfundimin e periudhës së Programit, pa qenë e nevojshme ndërmarrja e ndonjë veprimi shtesë nga Palët.

11.2. WVA ka të drejtë të përfundojë këtë Marrëveshje në mënyrë të njëanshme, me efekt të menjëhershëm, në rastet kur:

- Fëmija përjashtohet nga Programi për shkak të shkeljes së rregullave apo sjelljes së papërshtatshme;
- Prindi ka dhënë informacion të pasaktë ose të paplotë që ndikon në sigurinë ose mbarëvajtjen e Programit;
- Prindi nuk përmbush detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

11.3. Prindi ka të drejtë të tërheqë Fëmijën nga Programi në çdo kohë, me njoftim paraprak ndaj WVA, por në këtë rast pagesa e kryer nuk rimburohet.

Neni 12- Forca Madhore

12.1. Asnjë prej Palëve nuk do të jetë përgjegjëse për mospërmbushjen ose përmbushjen në vonesë ose të gabuar të detyrimeve të saj në masën dhe për aq kohë sa kjo mospërmbushje, përmbushje në vonesë ose e gabuar është për shkak të shkaqeve përtej kontrollit të saj të njohura si forca madhore, të cilat përfshijnë por pa u kufizuar në akte natyrore, akte shtetërore ose qeveritare, zjarri, shpërthime, pan/epidemi, mbyllje në karantine, mungesë e energjisë elektrike, embargo (“**Forca Madhore**”).

Neni 13- Klauzola e Juridiksionit

13.1. Kur midis Palëve nuk arrihet zgjidhja e mosmarrëveshjeve me mirëkuptim, secila prej Palëve mund t'i drejtohet Gjykatës kompetente e cila është Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

Neni 14- Të Ndryshme

14.1. Asnjë ndryshim, modifikim, përfundim, heqje dorë nga çdo parashikim i kësaj Marrëveshje, në asnjë rast nuk do të ketë efekt nëse nuk është me shkrim dhe e nënshkruar nga të dy Palët.

14.2. Përbëjnë pjesë përbërëse të kësaj Marrëveshje, Deklarimet Paraprake dhe Shtojcat e saj si më poshtë :

Shtojca A: Miratim për përpunimin e të dhënave personale;

Shtojca B: Miratim për përdorimin e fotografive dhe videove;

Shtojca C: Miratim për pjesëmarrje në aktivitete jashtë lokacionit;

Shtojca D: Rregullorja për sigurinë, mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve, dhe kodi i sjelljes.

NË DËSHMI TË SA MË SIPËR, Palët si më sipër, nënshkruajnë këtë Marrëveshje.

PRINDI / KUJDESTARI LIGJOR

Z/Znj _____

WORLD VISION ALBANIA

SHTOJCA A: MIRATIM PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE

Në kuadër të Marrëveshjes për pjesëmarrjen në Programin SfidON të organizuar nga WVA, unë, i nënshkruari: _____ **Prindi/Kujdestar Ligjor i Fëmijës** _____

deklaroj dhe pranoj si më poshtë

Jap pëlqimin tim që WVA të përpunojë të dhënat personale të Fëmijës dhe të miat, vetem për qëllime që lidhen me regjistrimin, organizimin, administrimin dhe zhvillimin e Programit, si dhe për garantimin e sigurisë dhe mirëqenies së Fëmijës. Të dhënat që mund të përpunohen përfshijnë, por pa u kufizuar në:

- të dhëna identifikuese (emër, mbiemër, moshë);
- të dhëna kontakti;
- informacion shëndetësor i nevojshëm (alergji, gjendje të veçanta, etj.);
- çdo informacion tjetër i domosdoshëm për pjesëmarrjen në Program.

WVA angazhohet të zbatojë masa të përshtatshme teknike dhe organizative për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me legjislacionin në fuqi, përfshirë Ligjin nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale". Këto masa përfshijnë, ndër të tjera, kontrollin e aksesit në të dhëna vetem për persona të autorizuar, ruajtjen e sigurt të dokumentacionit fizik dhe elektronik, përdorimin e sistemeve të mbrojtura për përpunimin e të dhënave, si dhe trajnimin e stafit për respektimin e detyrimeve ligjore në fushën e privatësisë dhe konfidencialitetit. WVA merr të gjitha masat e arsyeshme për të parandaluar aksesin e paautorizuar, humbjen, shpërdorimin, zbulimin apo përpunimin e paligjshëm të të dhënave personale.

Të dhënat personale nuk do t'u komunikohen palëve të treta, përveç rasteve kur kjo është e domosdoshme për organizimin dhe zhvillimin e Programit (p.sh. ofrues shërbimesh të autorizuar), kërkohet nga legjislacioni në fuqi apo nga autoritetet kompetente, ose kur është e nevojshme për mbrojtjen e jetës, shëndetit apo sigurisë së Fëmijës. Në çdo rast, WVA garanton që çdo palë e tretë të jetë subjekt i detyrimeve për konfidencialitet dhe mbrojtje të të dhënave në përputhje me ligjin.

Prindi deklaron se është informuar në mënyrë të plotë dhe të kuptueshme mbi përpunimin e të dhënave personale dhe jep pëlqimin e tij/saj të lirë, specifik dhe të informuar për përpunimin e këtyre të dhënave në përputhje me këtë Marrëveshje dhe legjislacionin në fuqi.

Data: _____

Nënshkrimi: _____

SHTOJCA B: MIRATIM PËR PËRDORIMIN E FOTOGRAFIVE DHE VIDEOVE

Ne kuadër të Marrëveshjes për pjesëmarrjen në Programin SfidON, të organizuar nga WVA, unë, i nënshkruari
_____ **Prindi/Kujdestar Ligjor i Fëmijës** _____

deklaroj dhe pranoj si më poshtë

WVA mund të realizojë fotografi, pyetje dhe/ose video gjatë aktiviteteve të Programit për qëllime dokumentimi, raportimi institucional, komunikimi dhe promovimi (përfshirë publikimin në rrjete sociale, faqe zyrtare dhe materiale informuese). WVA angazhohet që përdorimi i imazhit të Fëmijës të bëhet në mënyre dinjitoze, pa cënuar integritetin, privatësinë apo interesin më të lartë të tij/saj.

Ky pëlqim është vullnetar dhe nuk përben kusht për pjesëmarrjen në Program.

Zgjedhja e Prindit

- PO, jap pëlqimin për përdorimin e fotografive dhe/ose videove
- JO, nuk jap pëlqimin

Prindi ka të drejtë të tërheqë këtë pëlqim në çdo kohë, me njoftim të arsyeshëm ndaj WVA.

Data: _____

Nënshkrimi: _____

SHTOJCA C: MIRATIM PËR PJESËMARRJE NË AKTIVITETE JASHTË VENDNDODHJES SË KAMPIT

Në kuadër të Marrëveshjes për pjesëmarrjen në Programin SfidON, të organizuar nga WVA, unë, i nënshkruari _____ **Prindi/Kujdestar Ligjor i Fëmijës** _____

deklaroj dhe pranoj si më poshtë

Jap pëlqimin tim që Fëmija të marrë pjesë në aktivitete që zhvillohen jashtë vendndodhjes së zakonshme të Programit, përfshirë dalje në natyrë, aktivitete edukative, rekreative apo sportive. Jam i informuar se WVA do të organizojë këto aktivitete duke marrë masa të arsyeshme sigurie dhe duke përdorur procedura në përputhje me legjislacionin dhe standardet në fuqi. Pranoj se aktivitete të tilla mund të përfshijnë rreziqe të zakonshme dhe të arsyeshme dhe i pranoj ato si pjesë e natyrës së Programit.

Ky pëlqim është vullnetar dhe nuk përbën kusht për pjesëmarrjen në Program.

Zgjedhja e Prindit

- PO, jap pëlqimin
- JO, nuk jap pëlqimin

Prindi ka të drejtë të tërheqë këtë pëlqim në çdo kohë, me njoftim të arsyeshëm ndaj WVA.

Data: _____

Nënshkrimi: _____

SHTOJCA D: RREGULLORJA PËR SIGURINË, MBROJTJEN DHE MIRËQENIEN E FËMIJËVE, DHE KODI I SJELLJES

Siguria, Mbrojtja dhe Mirëqenia e Fëmijëve Kampi Veror “SfidON” Informacion për Prindërit

Ne e dimë që t'i besosh fëmijën dikujt tjetër është një akt i madh besimi. Ne angazhohemi që ky besim të meritohet çdo ditë, përmes përgjegjësisë, transparencës dhe kujdesit. Në Kampin Veror “SfidON”, fëmija juaj nuk është thjesht pjesëmarrës.

Për ne, siguria dhe mirëqenia e fëmijëve janë përparësi absolute. Çdo aktivitet që organizojmë udhëhiqet nga parimi: “Së pari, mos dëmto.” Kjo do të thotë që:

- punojmë për të **parandaluar çdo formë dhune, abuzimi, shfrytëzimi apo rreziku** ndaj fëmijëve;
- reagojmë **menjëherë dhe me përgjegjësi** ndaj çdo shqetësimi apo dyshimi;
- vendosim gjithmonë **interesin më të mirë të fëmijës** në qendër të çdo vendimi.

Ky kamp veror zbatohet plotësisht në përputhje me **Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe të Rriturve të World Vision Albania**, si dhe me legjislacionin shqiptar për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve.

2. Çfarë nënkuptojmë me “mbrojtje të fëmijëve”?

Të gjitha masat që marrim për të:

- parandaluar dhunën fizike, emocionale apo seksuale;
- parandaluar neglizhimin, poshtërimin apo trajtimin e padrejtë;
- parandaluar shfrytëzimin apo keqpërdorimin e pozitës së besimit nga të rriturit;
- krijuar një mjedis të sigurt, të ngrohtë, respektues dhe të mbështetës për çdo fëmijë.

3. Si e mbrojmë fëmijën tuaj gjatë kampit?

a) Staf i përzgjedhur dhe i trajnuar

Të gjithë personat që punojnë në kamp (drejtues, liderë grupi, asistentë, staf logjistik):

- përzgjidhen me kujdes;
- verifikohen sipas kërkesave ligjore;
- trajnohen mbi mbrojtjen e fëmijëve, sjelljen profesionale dhe menaxhimin e situatave sensitive;
- nënshkruajnë dhe respektojnë një Kod Sjelljeje të detyrueshëm.

b) Sjellje të lejuara dhe të ndaluara

Stafi i kampit:

- ndërton marrëdhënie të bazuara në **respekt, kujdes dhe kufij profesionalë**;
- përdor gjithmonë disiplinë pozitive, pa dhunë, frikësim apo poshtërim;
- **nuk lejohet** të qëndrojë vetëm apo i izoluar me një fëmijë;
- **nuk lejohet** asnjë formë kontakti të papërshtatshëm fizik apo verbal;
- **nuk tolerohet** asnjë formë abuzimi, shfrytëzimi apo diskriminimi.

Ne si organizatorë kemi **tolerancë zero** ndaj çdo shkeljeje të këtyre rregullave.

4. Siguria fizike dhe shëndetësore

Gjatë kampit sigurojmë që:

- të respektohen raportet e duhura staf–fëmijë;
- fëmijët të mbikëqyren vazhdimisht gjatë aktiviteteve, pushimeve dhe transportit;
- të kemi materiale të ndihmës së parë dhe staf të trajnuar për situata emergjente;
- të merren në konsideratë informacionet shëndetësore që prindërit deklarojnë (alergji, medikamente, nevoja të veçanta);
- çdo incident, sado i vogël, të dokumentohet dhe të trajtohet me seriozitet.

5. Si trajtohen shqetësimet apo incidentet?

Nëse gjatë kampit:

- një fëmijë ndihet i pasigurt, i shqetësuar apo i lënduar;
- një prind ka një dyshim apo shqetësim;
- një anëtar i stafit identifikon një situatë rreziku,

atëherë:

- situata raportohet menjëherë;
- merren masa për sigurinë e fëmijës;
- ndiqen procedura të qarta raportimi dhe menaxhimi;
- ruhet konfidencialiteti dhe dinjiteti i fëmijës dhe familjes.

SfidON ka struktura të posaçme për trajtimin e këtyre rasteve dhe, kur është e nevojshme, bashkëpunon me autoritetet përkatëse, gjithmonë duke mbrojtur interesin e fëmijës.

6. Komunikimi me prindërit

Ne e konsiderojmë prindin si **partner kyç** në mirëqenien e fëmijës. Për çdo shqetësim, prindërit mund t'i drejtohen koordinatorit të kampit ose stafit përgjegjës.

Gjatë zhvillimit të kampit:

- prindërit informohen për çështje të rëndësishme që lidhen me fëmijën e tyre;
- çdo komunikim bëhet me profesionalizëm, respekt dhe kujdes;
- çështjet sensitive trajtohen në mënyrë të përgjegjshme dhe konfidenciale.

7. Çfarë presim edhe nga ju si prindër?

Për të garantuar një kamp të sigurt dhe pozitiv për të gjithë fëmijët, ju ftojme të:

- ndani informacione të sakta mbi shëndetin dhe nevojat e fëmijës;
- informoni stafin për çdo shqetësim që mund të keni;
- inkurajoni fëmijën të flasë hapur nëse diçka e bën të ndihet jo rehat;
- bashkëpunoni me ekipin e kampit në rast situatash të veçanta.

Kampi Veror "SfidON"

Pse kemi një Kod Etike?

Në Kampin Veror "SfidON", ne besojmë se siguria, dinjiteti dhe mirëqenia e fëmijëve ndërtohen nga mënyra si sillemi të gjithë, çdo ditë.

Ky Kod Etike:

- përcakton pritshmëritë e sjelljes për të gjithë palët e përfshira në kamp;
- ndihmon në krijimin e një mjedisi të sigurt, respektues dhe të drejtë;
- mbështet vlerat dhe misionin e World Vision Albania.

Për kë aplikohet ky Kod?

Ky Kod Etike aplikohet për:

- stafin e kampit;
- fëmijët pjesëmarrës;
- prindërit dhe kujdestarët;
- vizitorët, partnerët dhe furnitorët.

Të gjithë më sipër janë përgjegjës për ta respektuar.

Parimet bazë të sjelljes sonë

Ne angazhohemi që në çdo ndërveprim të tregojmë:

- **Respekt dhe dinjitet** ndaj çdo fëmije dhe të rrituri, pa përjashtim.
- **Ndershmëri dhe integritet** në fjalë dhe në veprime.
- **Barazi dhe mosdiskriminim** pa paragjykime apo favorizime.
- **Përgjegjësi** për sigurinë dhe mirëqenien e fëmijëve.
- **Bashkëpunim dhe komunikim të shëndetshëm.**

Çfarë pritet nga stafi i kampit?

Stafi i kampit:

- sillet në mënyrë profesionale dhe etike;
- vendos gjithmonë interesin më të mirë të fëmijës në vëmendje;
- përdor disiplinë pozitive, pa dhunë, frikësim apo fyerje;
- respekton kufij të qartë dhe të shëndetshëm në marrëdhëniet me fëmijët;
- nuk toleron asnjë formë abuzimi, shfrytëzimi apo keqpërdorimi të pushtetit;
- raporton menjëherë çdo shqetësim apo dyshim për sigurinë e fëmijëve.

Çfarë pritet nga fëmijët?

Fëmijët pritet që të:

- respektojnë njëri-tjetrin dhe stafin;
- ndjekin rregullat e kampit për sigurinë e të gjithëve;
- shprehin mendimet dhe ndjenjat e tyre në mënyrë të sigurt;
- kërkojnë ndihmë nëse diçka i bën të ndihen jo rehat.

Çfarë pritet nga prindërit dhe kujdestarët?

Prindërit dhe kujdestarët pritet të:

- bashkëpunojnë me stafin e kampit;
- komunikojnë me respekt dhe mirëbesim;
- ndajnë informacione të rëndësishme për fëmijën (shëndet, nevoja të veçanta);
- raportojnë çdo shqetësim në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të përgjegjshme;
- respektojnë procedurat dhe rregullat e kampit.

Çfarë NUK lejohet në asnjë rast?

Në kamp **nuk tolerohet**:

- dhuna fizike, verbale apo psikologjike, përfshirë atë digjitale;
- abuzimi ose shfrytëzimi i fëmijëve;
- sjellja poshtëruese, kërcënuese apo diskriminuese;
- përdorimi i alkoolit, drogës apo substancave të tjera të ndaluara;
- shkelja e kufijve personalë dhe profesionalë;
- fshehja ose mosraportimi i situatave shqetësuese.

Shkeljet e këtij Kodi trajtohen me seriozitet dhe mund të sjellin masa përkatëse.

Si raportohen shqetësimet?

Çdo person ka të drejtë dhe përgjegjësi të raportojë një shqetësim, të kërkojë sqarim dhe të flasë pa frikë nga ndëshkimi. Raportimi mund të bëhet drejtpërdrejt tek koordinatori i kampit.

Raportimet trajtohen me konfidencialitet, respekt dhe fokus te siguria dhe mirëqenia e fëmijës.

Angazhimi ynë i përbashkët

Ky Kod Etike nuk është thjesht një dokument.

Është **angazhimi ynë i përbashkët** që Kampi "SfidON" të jetë një hapësirë ku:

- fëmijët ndihen të sigurtë,
- prindërit ndihen të qetë,
- dhe të rriturit sillen me përgjegjësi dhe integritet.